



FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO TENNIS FEDERATION

Kosova Tennis Federation
House of sports
Agim Ramadani str,
10000 Prishtina
Kosovo
T: +383 45 746 543
www.tenniskosova.com

RREGULLORE NR#13 PËR PUNËN E KUVENDIT TË FEDERATËS SË TENISIT TË KOSOVËS

2022, Prishtinë



Në bazë të nenit 5. të Statutit të Federatës së Tenisit të Kosovës, Kuvendi i Federatës së Tenisit të Kosovës (në tekstin e mëtejme ‘Kuvendi’), në mbledhjen e vet të mbajtur më **17 Nëntor 2022** në Prishtinë, miratoi këtë:

RREGULLORE TË PUNËS SË KUVENDIT TË FEDERATËS SË TENISIT TË KOSOVËS

Neni 1

Qellimi

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e punës së Kuvendit të Federatës së Tenisit të Kosovës (në tekstin e mëtejme FTK) , në pajtim me Statutin e FTK-së. Kjo Rregullore përcakton specifikisht dispozitat lidhur me:

- a. Përgatitjen dhe thirjen e Kuvendit,
- b. Udhëheqjen e mbledhjeve të Kuvendit,
- c. Mënyrën e aprovimit të vendimeve dhe konkluzioneve të Kuvendit dhe
- d. Informimin për punën e Kuvendit të Federatës.

Neni 2

Mbledhjet e Kuvendit

1. Mbledhjet e Kuvendit mund të jenë të rregullta (Kuvend i punës apo kuvend zgjedhor) dhe të jashtëzakonshme (Kuvend i Jashtëzakonshëm). Kuvendet në raste të caktuara mund të mbahen edhe online përmes internetit pa praninë fizike.
2. Kuvendi i Federatës së Tenisit të Kosovës do të mbajë së paku një mbledhje të rregullt në vit. Sipas nevojës, Kuvendi mund të thirret edhe më shpesh.
3. Në mbledhje të jashtëzakonshme Kuvendi mund të trajtojë vetëm çështjet për të cilat është thirur.

Neni 3

Thirja dhe mbajtja e mbledhjes

1. Kuvendet konvokohen dhe mbahen në pajtim me nenin 5 paragrafi 5.2 të Statutit të FTK-së.

Neni 4

Rendi i ditës dhe Materialet

1. Rendin e ditës e përgadit Kryetari në bashkëpunim me sekretarin e përgjithshëm dhe anëtarët e bordit, që paraprakisht miratohet nga bordi e pastaj ju dërgohet delegatëve se bashku me materialet tjera. Rendi i ditës obligativisht përmbanë:

- 1.1. procesverbalin nga mbledhja e kaluar
- 1.2. pranimin për anëtarët e rinj (nëse ka)



- 1.3. propozimet për ndryshime të akteve normative (nese ka) dhe
- 1.4. materialet që do të shqyrtohen në mbledhje

2. Propozimet për plotësimin apo ndryshimin e rendit të ditës mund të bëhen edhe nga anëtarët e Kuvendit me shkrim më së largu njëzetë e katër (24) orë para mbajtjes së Kuvendit.
3. Materialet për mbledhjen e Kuvendit përgaditën nga Kryetari në bashkëpunim me sekretarin e përgjithshëm. Materialet për mbledhje të Kuvendit të FTK-së i shqyrton dhe i miraton paraprakisht Bordi i FTK-së. Materialet e obligueshme për mbledhje të Kuvendit janë:
 - 3.1. Raporti i punës
 - 3.2. Raporti financiar dhe i Auditimit
 - 3.3. Raporti i këshillit mbikqyrës
 - 3.4. Draft buxheti dhe drafti i planit të punës
 - 3.5. Tjera sipas rendit të ditës

Neni 5

Udhëheqja e mbledhjes së kuvendit

1. Mbledhjet e Kuvendit i hap Kryetari i FTK-së i cili edhe propozon organet e punës së Kuvendit (Komisionin Verifikues dhe Procesmbajtësin). Komisioni Verifikues duhet të vërtetojë kuorumin e domosdoshëm për mbajtjen e mbledhjes në pajtim me Statutin e Federatës. Mbledhja e Kuvendit mbahet nëse në të janë të pranishëm 50% +1 e delegatëve të Kuvendit.
2. Kuvendin e rregullt dhe të jashtëzakonshëm e udhëheqë kryetari së bashku me nënkryetarin e parë dhe sekretarin e përgjithshëm.
3. Kryesinë e punës në mbledhjet e Kuvendit zgjedhor do ta përbëjnë sekretari i përgjithshëm i FTK-së dhe dy delegatë të Kuvendit.
4. Pas konstatimit se ekziston kuorumi, kryesuesi i seancës propozon miratimin e rendit të ditës së mbledhjes së Kuvendit. Miratimi i rendit të ditës bëhet me shumicë votash, ndërsa çdo anëtar i Kuvendit ka të drejtë të propozojë plotësimin e rendit të ditës, të cilën duhet ta bëjë me shkrim të pakten njëzet e katër (24) orë para mbledhjes. Propozimet e tilla duhet të votohen nga 50% + 1 e Anëtarëve të pranishëm në Kuvend.
5. Në rast se Kryetari i Kuvendit për çfarëdo arsye nuk është i pranishëm në mbledhje të Kuvendit, Kuvendin e udhëheq njëri nga Nënkyetarët e Bordit të Federatës, ose në mungesë të tyre, delegati më i vjetër i pranishëm në mbledhjen e Kuvendit.



6. Kryesia e Kuvendit kujdeset që gjatë mbledhjes janë trajtuar të gjitha pikat e rendit të ditës, dhe nuk e shpallin të përfunduar mbledhjen pa u trajtuar të gjitha pikat e rendit të ditës.

7. Kryesia e Kuvendit dhe pjesëmarrësit në mbledhjen e Kuvendit janë të obliguar që t'i përmbahen kësaj rregulloreje.

Neni 6 **Ecuria e mbledhjes**

1. Pas miratimit të rendit të ditës kalohet në shqyrtim dhe vendosje për çështjet që janë në kuadër të pikave të miratuara të rendit të ditës.

2. Raportin dhe arsyetimin rreth secilës pikë të rendit të ditës e paraqet kryesuesi ose personi i caktuar prej tij, pas të cilit kryesuesi e hap diskutimin.

3. Kryetari ka të drejtë ta ndërpresë mbledhjen, nëse ai konstaton se nuk ka kushte normale për mbajtjen e mbledhjes.

4. Në bazë të propozimit të kryesuesit apo të ndonjë anëtari të Kuvendit, kuvendi mund të vendosë me shumicë votash, që shqyrtimi për disa çështje të caktuara të ndërpritet dhe të përgatitet më hollësisht për mbledhjen e ardhshme.

Neni 7 **Diskutimet në kuvend**

1. Delegati i Kuvendit mund të flasë vetëm për çështjen e cila është duke u shqyrtuar sipas rendit të ditës. Nëse diskutimi devijon nga rendi i ditës, Kryesuesi i mbledhjes ka të drejtë t'ia tërheq vërejtjen ose ta ndërpresë diskutimin.

2. Asnjë delegat i Kuvendit nuk mund ta marrë fjalën më tepër se një herë për një pikë të caktuar të rendit të ditës. Diskutimi i delegatëve mund të zgjas më së shumti pesë (5) minuta.

3. Secili delegat ka të drejtë në një replikë (e cila zgjatë jo më shumë se një minutë) nëse i përmendet, apo i apostrofohet emri në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

4. Delegati i cili nuk respekton kodin e mirësjelljes apo përdorë gjuhë ofenduse ndaj të tjerëve mund të përjashtohet nga mbledhja e Kuvendit nga kryesuesi.



Neni 8

Mënyra e miratimit të vendimeve të kuvendit

1. Kuvendi vendimet e veta i merr në bazë të Statutit të FTK-së.

Neni 9

Zgjedhja dhe emërimi i organeve të federatës në Kuvend

1. Kuvendi në pajtim me nenin 5 paragrafi 5.6 të Statutit të FTK-së është kompetent për zgjedhjen e organeve të FTK-së
2. Pesëmbdhjet ditë para Kuvendit në pajtim me statutin e FTK-së, delegatët propozojnë kandidatët për kryetar të FTK-së.
3. Forma e votimit në kuvend është publike, kurse e fshehtë në rastin e zgjedhjes së kryetarit, nënkryetarëve dhe bordit të FTK.
4. Kryetar i zgjedhur i Federatës konsiderohet kandidati që ka fituar 50% +1 të votave të delegatëve të pranishëm në mbledhjen e Kuvendit.
5. Në qoftë se asnjëri nga kandidatët e propozuar për Kryetar nuk e merr këtë numër të votave në rrethin e parë, atëherë në rrethin në rrethin e dytë të votimit delegatët e Kuvendit votojnë për dy (2) kandidatët të cilët në rrethin e parë kanë marrë numrin më të madh të votave. Pas votimit në rrethin e dytë, për Kryetar zgjedhet kandidati i cili ka fituar numrin më të madh të votave.
6. Të drejtën e propozimit të kandidatëve për nënkryetarë e kanë:
 - a) Kryetari, i cili mund t'i propozojë një kandidatë, dhe
 - b) Delegatet e kuvendit që mund t'i propozojnë një kandidatë tjerër (në të dy rastet së paku njëri kandidat duhet të jetë i gjinisë femërore).
7. Nënkryetarë do të zgjedhen dy kandidatët që marrin numrin më të madh të votave të delegatëve. Në rast se të dy kandidatët që kanë marrë më së shumti vota janë nga e njëjta gjini, kandidati nga gjinia e kundërt që ka marrë më shumë vota do të zë vendin e nënkryetarit të dytë.
8. Anëtarët e Bordit zgjedhen me vota të fshehta nga Kuvendi. Lista e kandidatëve përfshin emrat e kandidatëve dhe profilet e tyre në Bord..
 - a) Dy anëtarë të tjerë të Bordit i propozon Kryetari.



b) Dy anëtar të Bordit i propozojnë Delegatët e Kuvendit.

9. Tre anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Federatës i propozojnë delegatët e Kuvendit, ndërsa në rast se paraqiten më shumë se tre delegatë, anëtarësinë në këtë Këshillë e fitojnë kandidatët që marrin më së shumti vota.

Neni 10

Mënyra e informimit me punën e kuvendit

1. Me punën e Kuvendit rregullisht informohen anëtarët e FTK-së, MKRS, KOK dhe opinionin publik. Informimi bëhet me anë të mjeteve të informimit dhe raporteve.
2. Për punën e Kuvendit dhe organeve të tij në mbledhje në mënyrë të obligueshme mbahet procesverbali nga procesmbajtësi. Në procesverbal duhet të shënohet e tërë rrjedha e mbledhjes së Kuvendit. Procesverbalin e nënshkruajnë Kryetari dhe procesmbajtësi.

Neni 11

Aplikimi dhe zbatimi

Të gjitha çështjet që nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore, do të vlejné dhe zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e Statutit të FTK-së..

Neni 12

Aprovimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore konsiderohet e aprovuar po qe se për të votojn 50% +1 e anëtarëve të pranishëm të Kuvendit.
2. Ndërrimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje, bëhen në të njëjtën mënyrë sikurse edhe miratimi i saj.
3. Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Kuvendi i FTK-së.

Kryetari i FTK-së
Jeton Hadërgjonaj



17 Nëntor 2022